



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmena • Ombudsperson Institution

Ex officio

Nr. 214/2018

RAPORT ME REKOMANDIME

I AVOKATIT TË POPULLIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

në lidhje me

arrestimin dhe largimin me forcë të gjashtë shtetasve turq nga territori i Republikës së Kosovës

Për: Z. Bejtush Gashi, Ministër
Ministria e Punëve të Brendshme
Z. Abelard Tahiri, Ministër
Ministria e Drejtësisë

Kopje për: Z. Hashim Thaqi, Kryetar i Republikës së Kosovës
Z. Kadri Veseli, Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës
Z. Ramush Haradinaj, Kryeministër i Republikës së Kosovës
Znj. Duda Balje, Kryetare e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi
Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione

Prishtinë, më 27 prill 2018

QËLLIMI I RAPORTIT

1. Qëllimi kryesor i këtij raporti është tërheqja e vëmendjes autoriteteve kompetente të Republikës së Kosovës për respektimin e të drejtave të personave të arrestuar dhe personave subjekt i largimit me forcë apo ekstradimit nga territori i Republikës së Kosovës, në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës, si dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

BAZA KUSHTETUESE DHE LIGJORE

2. Sipas nenit 135, par. 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: “Kushtetuta”), “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga organet e administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore”.
3. Sipas Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 16, par. 4, “Avokati i Popullit ka kompetencë të bëjë hetime . . . me iniciativën e vet (ex officio), nëse nga konstatimet, dëshmitë dhe faktet e paraqitura me parashtrësë ose nga njohuritë e fituara në mënyrë tjetër, ka bazë të rezultojë se nga ana e autoriteteve janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut të përcaktuara me Kushtetutë, ligje dhe akte të tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut”.
4. Gjithashtu, Ligji Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 18, par. 1 përcakton se Avokati i Popullit, mes të tjerash, ka edhe këto përgjegjësi:
 - “të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tilla” (pika 2);
 - “të rekomandojë Qeverinë, Kuvendin dhe autoritetet tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit” (pika 5);
 - “t’i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta” (pika 6);
 - “të rekomandojë nxjerrjen e ligjeve të reja në Kuvend, ndryshimin e ligjeve që janë në fuqi dhe nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga institucionet e Republikës së Kosovës” (pika 7);
 - “të përgatitë raporte vjetore, periodike dhe të tjera mbi gjendjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit dhe të kryejë hulumtime mbi çështjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit në Republikën e Kosovës” (pika 8); dhe
 - “t’i rekomandojë Kuvendit harmonizimin e legjislacionit me standardet ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut si dhe zbatimin e tyre efektiv” (pika 9).

Me dërgimin e këtij raporti tek institucionet përgjegjëse, Avokati i Popullit synon të kryejë këto përgjegjësi kushtetuese dhe ligjore.

Faktet e rastit

5. Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16.4 të Ligjit nr. 05/L -019 për Avokatin e Popullit, sipas informacioneve të publikuara nga mjetet e informimit publik RTK, TV 21 dhe media tjera, të datës 29 mars 2018, ka vendosur të hapë hetime sipas detyrës zyrtare “*Ex officio*”, lidhur me arrestimin dhe largimin me forcë të gjashtë shtetasve turq nga Republika e Kosovës, respektivisht:

Z. Mustafa Erdem, Drejtorja për Shtetësi Azil dhe Migrim (në tekstin e mëtejshëm “DSHAM”) më 23 mars 2018, ia revokoi leje qëndrimin bazuar në nenin 91 paragrafi 1, nën paragrafi 1.4, paragrafi 2, 3 dhe 4 i Ligjit nr. 04/L-219 për të Huajt dhe nenit 26 të Udhëzimit Administrativ (MPB) nr. 01/2014 për Procedurën e Lëshimit të Lejes së Qëndrimit për të Huajt dhe Vërtetimit të Lejes së Punës. Leje qëndrimi në rastin e z. Erdem ishte valid deri më 23 shkurt 2021. Më 29 mars 2018, Drejtorja për Migrim dhe të Huaj në Policinë e Kosovës, në bazë të nenit 6, 97 dhe 99, paragrafi 2 i Ligjit nr. 04/L219 dhe nenit 8 paragrafi 1 të Udhëzimit Administrativ (MPB) nr. 09/2014 për Kthimin e të Huajve me Qëndrim të Paligjshëm në Republikën e Kosovës, lëshoi Urdhër për Largim me Forcë të Z. Erdem, i cili u zbatua në të njëjtën ditë.

Z. Hasan Husejin Demir, DSHAM më 23 mars 2018, ia revokoi leje qëndrimin bazuar në nenin 66 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenit 48 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 i Ligjit nr. 04/L-219 për të Huajt, nenit 23 të Udhëzimit Administrativ (MPB) nr. 01/2014 për Procedurën e Lëshimit të Lejes së Qëndrimit për të Huajt dhe Vërtetimit të Lejes së Punës. Leje qëndrimi në rastin e z. Demir ishte valid deri më 21 qershor 2018. Më 29 mars 2018, Drejtorja për Migrim dhe të Huaj në Policinë e Kosovës, në bazë të nenit 6, 97 dhe 99, paragrafi 2 i Ligjit nr. 04/L219 dhe nenit 8 paragrafi 1 të Udhëzimit Administrativ (MPB) nr. 09/2014 për Kthimin e të Huajve me Qëndrim të Paligjshëm në Republikën e Kosovës, lëshoi Urdhër për Largim me Forcë të Z. Demir, i cili u zbatua në të njëjtën ditë.

Z. Yusuf Karabina, DSHAM më 23 mars 2018, ia revokoi leje qëndrimin bazuar në nenin 91, paragrafi 1, nën paragrafi 1.4, paragrafi 2, 3 dhe 4 të Ligjit nr. 04/L-219 për të Huajt dhe nenit 26 të Udhëzimit Administrativ (MPB) nr. 01/2014 për Procedurën e Lëshimit të Lejes së Qëndrimit për të Huajt dhe Vërtetimit të Lejes së Punës. Leje qëndrimi në rastin e z. Karabina ishte valid deri më 3 gusht 2022. Më 29 mars 2018, Drejtorja për Migrim dhe të Huaj në Policinë e Kosovës, në bazë të nenit 6, 97 dhe 99, paragrafi 2 i Ligjit nr. 04/L219 dhe nenit 8 paragrafi 1 të Udhëzimit Administrativ (MPB) nr. 09/2014 për Kthimin e të Huajve me Qëndrim të Paligjshëm në Republikën e Kosovës, lëshoi Urdhër për Largim me Forcë të Z. Karabina, i cili u zbatua në të njëjtën ditë.

Z. Cihan Özkan, DSHAM më 23 mars 2018, ia revokoi leje qëndrimin bazuar në nenin 66 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenit 48 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit nr. 04/L-219 për të Huajt dhe nenit 23 të Udhëzimit Administrativ (MPB) nr. 01/2014 për Procedurën e Lëshimit të Lejes së Qëndrimit për të Huajt dhe Vërtetimit të Lejes së Punës. Leje qëndrimi në rastin e z. Cihan ishte valid deri më 21 shtator 2018. Më 29 mars 2018, Drejtorja për

Migrim dhe të Huaj në Policinë e Kosovës, në bazë të nenit 6, 97 dhe 99, paragrafi 2 i Ligjit nr. 04/L219 dhe nenit 8 paragrafi 1 të Udhëzimit Administrativ (MPB) nr. 09/2014 për Kthimin e të Huajve me Qëndrim të Paligjshëm në Republikën e Kosovës, lëshoi Urdhër për Largim me Forcë të Z. Özkan, i cili u zbatua në të njëjtën ditë.

Z. **Kahraman Demirez**, DSHAM më 23 mars 2018, ia revokoi leje qëndrimin e tij bazuar në nenin 91 paragrafi 1, nën paragrafi 2, 3 dhe 4 të Ligjit nr. 04/L-219 për të Huajt dhe nenin 26 të Udhëzimit Administrativ (MPB) nr. 01/2014 për Procedurën e Lëshimit të Lejes së Qëndrimit për të Huajt dhe Vërtetimit të Lejes së Punës. Leje qëndrimi në rastin e z. Demirez ishte valid deri më 23 shkurt 2021. Më 29 mars 2018, Drejtoria për Migrim dhe të Huaj në Policinë e Kosovës, në bazë të nenit 6, 97 dhe 99, paragrafi 2 i Ligjit nr. 04/L219 dhe nenit 8 paragrafi 1 të Udhëzimit Administrativ (MPB) nr. 09/2014 për Kthimin e të Huajve me Qëndrim të Paligjshëm në Republikën e Kosovës, lëshoi Urdhër për Largim me Forcë të Z. Demirez, i cili u zbatua në të njëjtën ditë.

Z.**Osman Karakaya**, sipas DSHAM, leje qëndrimi i kishte skaduar dy muaj më herët dhe kërkesa për vazhdim nuk u aprovua për shkak të vlerësimit nga organi kompetent se përbën rrezik për sigurinë kombëtare. Më 29 mars 2018, Drejtoria për Migrim dhe të Huaj e Policisë së Kosovës, në bazë të nenit 6, 97 dhe 99, paragrafi 2 i Ligjit nr. 04/L219 dhe nenit 8 paragrafi 1 të Udhëzimit Administrativ (MPB) nr. 09/2014 për Kthimin e të Huajve me Qëndrim të Paligjshëm në Republikën e Kosovës, lëshoi Urdhër për Largim me Forcë të Z. Karakaya, i cili u zbatua në të njëjtën ditë.

6. Më 29 mars 2018, mediat e shkruar dhe elektronike publikuan lajmin se Policia e Kosovës ka arrestuar dhe larguar nga territori i Republikës së Kosovës gjashtë shtetas turq të cilët në Republikën e Kosovës qëndronin mbi bazën e lejeve për qëndrim të përhershëm dhe të përkohshëm të lëshuara nga Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migracion (në tekstin e mëtejshëm “DSHAM”).
7. Po në të njëjtën ditë, mediat publikuan një komunikatë nga DSHAM në të cilën theksohej: “... *ne si organ kompetent, gjatë administrimit të provave kemi konstatuar se për personat në fjalë, ka bazë të mjaftueshme ligjore që të merren masat për revokimin e leje qëndrimit të tyre në territorin e Republikës së Kosovës për arsye të përcaktuara me ligjin për të huaj, konkretisht nenit 6 të ligjit ku flet për refuzimin apo revokimin e lejes së qëndrimit për rrethanat e sigurisë shtetërore*”, thuhet në njoftim të MPB-së”.¹
8. Më 30 mars 2018, Departamenti për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtarë në Çështje Penale i Ministrisë së Drejtësisë e njoftoi Avokatin e Popullit se pranë këtij departamenti nuk janë zhvilluar procedura për ekstradim për personat e arrestuar dhe larguar me forcë nga territori i Republikës së Kosovës.
9. Më 29 mars 2018, Mekanizmi Kombëtarë për Parandalim të Torturës (në tekstin e mëtejshëm “MKPT”) i Avokatit të Popullit kërkoi nga Qendra e Mbajtjes për të Huajt (në tekstin e mëtejshëm “QMH”) që të njoftohet nëse të huajt e arrestuar gjenden në këtë qendër. Zyrtari

¹ Shih në: <http://www.gazetaexpress.com/lajme/keta-jane-6-shtetasit-qe-u-deportuan-me-kerkese-te-erdoganit-517803/>, (29 mars 2018).

kompetent i QMH e njoftoi MKPT se personat në fjalë nuk janë dërguar fare në QMH.²

10. Më 29 mars 2018 Avokati i Popullit përmes postës elektronike zyrtare kërkoi nga Policia e Kosovës dhe DSHAM të njoftohet lidhur me rastin në fjalë. Po në të njëjtën ditë Mekanizmi Kombëtarë Parandalues i Avokatit të Popullit vizitoi Qendrën Rajonale të Mbajtjes në Prishtinë (QRM)³ku u njoftua se të arrestuarit në fjalë nuk gjenden në këtë qendër.
11. Më 29 mars 2018, Fondacioni i Gazetarëve dhe Shkrimtarëve (Journalsits and Writers Foundation), përmes postës elektronike zyrtare i shprehu Avokatit të Popullit shqetësimin e thellë dhe kërkoi ndihmën e tij lidhur me arrestimin dhe dëbimin e gjashtë shtetasve në fjalë nga territori i Republikës së Kosovës.
12. Më 29 mars 2018, mediat Kosovare e publikun një lajm në të cilin i referohen gazetës turke “Hurriyet” në të cilin thuhet se Agjencia Kosovare e Inteligjencës në bashkëpunim me Agjencinë turke të inteligjencës e realizuan këtë operacion të suksesshëm të arrestimit duke iu referuar personave të arrestuar dhe të dëbuar nga territori i Republikës së Kosovës. I njëjti medium publikoi edhe fotografitë e personave të arrestuar.⁴
13. Më 30 mars 2018, MKPT vizitoi Qendrën Rajonale të Mbajtjes në Prishtinë (QRM), me ç’ rast ekipi monitorues zhvilloi një inspektim të hollësishëm për të verifikuar nëse personat në fjalë mbahen apo ishin mbajtur ditë më parë në këtë qendër. Ekipi monitorues po ashtu kontrolloi të gjithë regjistrat zyrtar në Qendrën Rajonale të Mbajtjes dhe konstatoi se të arrestuarit nuk gjendeshin në këtë qendër dhe nuk ishin dërguar fare aty.
14. Më 30 mars 2018, MKPT zhvilloi një takim zyrtar me Drejtorin e DSHAM dhe nga ky departament iu dorëzuan kopjet e vendimeve të DSHAM për revokimin e lejeve të qëndrimit në Republikën e Kosovës për personat në fjalë. Me këtë rast, MKPT kërkoi që DSHAM t’ia dorëzojë MKPT kopjet e dosjeve të secilit person të arrestuar.
15. Më 30 mars 2018, MKPT, përmes postës elektronike zyrtare kërkoi nga Drejtoria për Migrim dhe të Huajt në kuadër të Policisë së Kosovës që t’ia dërgojë dokumentet relevante lidhur me arrestimin dhe largimin me forcë të gjashtë shtetasve turq nga territori i Republikës së Kosovës.
16. Po në të njëjtën ditë, para dite, MKPT kërkoi takim me zyrtarët kompetent të Policisë së Kosovës nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë për të marrë dokumentacion relevant dhe për t’u njoftuar me procedurat e zbatuara në rastin e arrestimit, largimit me forcë dhe vendndodhjen e këtyre personave. Takimi nuk u realizua, mirëpo nga MKPT u kërkua që takimi të caktohet përmes kërkesës me shkrim.
17. Më 30 mars 2018, në ora 14:00, Drejtoria për Migrim dhe të Huajt, përmes postës elektronike zyrtare ia dërgoi MKPT “Urdhrat për Largim me Forcë” nga territori i Republikës së Kosovës për gjashtë shtetasit turq. Me këtë rast, MKPT po ashtu u njoftua se personat në fjalë nga kjo

² QMH (Qendra e Mbajtjes për të Huajt), sipas Ligjit për të Huajt, personat të cilat janë subjekt i largimit me forcë nga territori i Republikës së Kosovës akomodohen në këtë Qendër.

³ Në QMH, personat e arrestuar nga Policia e Kosovës mbahen deri në 48 orë dhe brenda këtij afati duhet të dërgohen para gjyqtarit të procedurës paraprake.

⁴ Shih në: <http://www.gazetaexpress.com/lajme/keta-jane-6-shtetasit-qe-u-deportuan-me-kerkese-te-erdoganit-517803/> (29.3.2018)

drejtori janë përcjellë menjëherë dhe në të njëjtën ditë janë dëbuar në shtetin e tyre të origjinës.

18. Më 30 mars 2018, Avokati i Popullit publikoi Deklaratë në të cilën ndër të tjera theksohet: *“Avokati i Popullit është jashtëzakonisht i shqetësuar me situatën e krijuar, që nga marrja e informatës për arrestimin e gjashtë shtetasve turq, me leje qëndrimi në vendin tonë. Janë bërë përpjekje të vazhdueshme për të siguruar informacion zyrtar për vendndodhjen dhe gjendjen e tyre, mënyrën e arrestimit dhe aktin e deportimit drejt shtetit të Turqisë, por kjo ka qenë e pamundur gjatë ditës së djeshme dhe paraditën e sotme. Pas insistimit të pandërprerë të Avokatit të Popullit, Policia e Kosovës (PK), respektivisht Drejtoria për Migrim dhe të Huaj (DMH), sot, më 30 mars 2018, në ora 14:00, ka njoftuar se, nga ana e DMH-së së PK-së, më datë 29 mars 2018, janë nxjerrë gjashtë Urdhra për largim me forcë të shtetasve në fjalë, nga territori i Republikës së Kosovës, për në Turqi. Lëshimi i këtyre Urdhër largimeve me forcë, është aplikuar duke u bazuar në Vendimet e Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migracion (DSHAM) të MPB-së, që mbajnë datën 23 mars 2018, të përcjella tek DMH, më 28 mars 2018. Sipas njoftimit të PK-së, shtetasit në fjalë janë ndaluar më 29 mars 2018 dhe janë përcjellë të njëjtën ditë, në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës, nga ku ka ndodhur dëbimi për në shtetin e tyre të origjinës. Gjatë ditës së djeshme, Avokati i Popullit, po ashtu, ka kontaktuar DSHAM-në në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe ka kërkuar të dijë nëse personat në fjalë po mbahen në Qendrën e mbajtjes për të huajt, por është njoftuar se ata nuk janë dërguar aty. Ndërkaq, gjatë ditës së sotme, po nga i njëjti Departament, është pranuar njoftimi se ka pasur Vendime për revokimin e leje qëndrimit të personave veç e veç dhe na janë përcjellë kopjet e këtyre Vendimeve. Duke pasur parasysh ndjeshmërinë dhe kompleksitetin e rastit dhe konfuzionin e autoriteteve mbi linjën e përgjegjësisë, Avokati i Popullit ka vendosur të hap rast Ex Officio, për të hetuar në detaje veprimet e ndërmarra nga autoritetet publike. Sidoqoftë, në këtë fazë, Avokati i Popullit pohon që veprimet e ndërmarra nga autoritetet publike janë në kundërshtim me standardet ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut, të zbatueshme në sistemin e brendshëm juridik të Republikës së Kosovës. Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj, saktëson qartë garancitë procedurale në lidhje me dëbimin e të huajve. Në kuptim të nenit 3, nenit 6, nenit 8 dhe nenit 13 të KEDNJ-së, ashtu si edhe Parimit themelor të mos-kthimit (non-refoulement) sipas Konventës për Refugjatë të vitit 1951, përgjegjësia bie tek autoritetet shtetërore kompetente lidhur me situatën e krijuar. Mbi të gjitha, garancitë e nenit 3 (ndalimi i torturës dhe trajtimit çnjerëzor dhe poshtëruës) dhe nenit 6 (e drejta për një proces të rregullt gjyqësor) të KEDNJ-së, në shoqëritë demokratike, nuk mund të shfuqizohen (derogohen), as në rrethanat e jashtëzakonshme.*
19. Më 30 mars 2018, Avokati i Popullit, përmes postës elektronike zyrtare kërkoi nga Agjencia Kosovare për Inteligjencë (AKI) që t'i dërgohet raporti i vlerësimit dhe rekomandimeve të kësaj agjencie lidhur me personat në fjalë.
20. Pas takimit me përfaqësuesin e AKI, Avokati i Popullit u njoftua se informacioni i kërkuar cilësohet i klasifikuar, i përcaktuar në nenin 4, paragrafi 1.3.1, të Ligjit Nr. 03/L-178, për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë.
21. Sipas nenit 22 paragrafi 2 të këtij ligji: “ Vetëm Presidenti i Republikës së Kosovës, Kryetari

i Kuvendit të Kosovës dhe Kryeministri janë të autorizuar të kenë qasje në informacionet e klasifikuara „,”

22. Sidoqoftë, sipas nenit 7 të po këtij ligji, thuhet se kompetencën për klasifikim e ka vetëm institucioni publik i cili e ka prodhuar informacionin. Paragrafi 2 i këtij neni përcakton se kompetencën origjinale për klasifikim e ka Presidenti i Kosovës, Kryetari i Kuvendit, Kryeministri, Kryesuesi i Këshillit të Sigurisë së Kosovës, Drejtori i Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës dhe Komandanti i Forcës së Sigurisë.
23. Më 30 mars 2018, pas kërkesës së avokatit mbrojtës dhe dyshimit të familjareve se ata ende po mbahen në hapësirat e aeroportit, ekipi monitorues i MKPT realizoi një vizitë në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës me qëllim të verifikimit nëse personat e arrestuar po mbaheshin ende aty. Përkundër insistimit të ekipit monitorues që të ketë qasje në hapësira dhe dokumentacion, ekipit nuk iu lejua qasja, duke ia pamundësuar kështu kryerjen e detyrës zyrtare në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Ligjin për Avokatin e Popullit.
24. Më 31 mars 2018, *Gazeta Express*, publikoi një artikull që i referohet deklaratës së prokurorit Reshat Millaku nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, i cili deklaroi se rreth kësaj çështjeje para disa ditësh kanë marrë kërkesë për ekstradim nga ana e Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës.⁵
25. Më tej në këtë artikull prokurori në fjalë deklaroi: *“Ne për këtë çështje nuk kemi nisur hetime. Por ka pasur kërkesë për ekstradim por nuk kemi vepru. Kërkesa ka shkuar përmes Ministrisë së Drejtësisë së Turqisë, drejtuar Ministrisë së Drejtësisë sonë. Ne nuk kemi vepru se nuk e kemi pa të arsyeshme të veprojmë”*.
26. Më 3 prill 2018, avokati mbrojtës i personave të arrestuar dhe larguar me forcë nga territori i Republikës së Kosovës e njoftoi Avokatin e Popullit se Urdhri për Largim me Forcë i Policisë së Kosovës dhe Vendimi për Revokim të Lejeve të Qëndrimit i DSHAM nuk u është dorëzuar as klientëve të tyre dhe as avokatëve mbrojtës.
27. Më 4 prill 2018, Avokati i Popullit i priti në një takim zyrtarët e Kolegjit “Mehmet Akif” të cilët shprehën shqetësimet e tyre lidhur me fatin e kolegëve të tyre të dëbuar në Turqi, por edhe për sigurinë e tyre dhe familjarëve të tyre duke shprehur frikën nga dëbimi dhe dorëzimi tek autoritetet turke.
28. Më 4 prill 2018, Avokati i Popullit sërish kërkoi nga DSHAM që t’i dorëzojë dokumentet relevante lidhur me vazhdimin e lejeve të qëndrimit të të dëbuarve në fjalë ashtu siç kishte kërkuar edhe gjatë takimit më 30 mars 2018. Po në të njëjtën ditë, rreth orës 15.00, DSHAM ia dorëzoi përfaqësuesit të Avokatit të Popullit, dokumentet e kërkuara.
29. Më 5 prill 2018, përfaqësuesit e Avokatit të Popullit, mbajtën takim me Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës lidhur me pohimet se në adresë të kësaj prokurorie ka ardhur një kërkesë për ekstradim.

⁵ Gazeta Express, 31 mars 2018, për më shumë shih në: <http://www.gazetaexpress.com/lajme/prokuroria-speciale-ne-refuzuam-ekstradimin-e-turqve-s-kemi-nisur-hetimet-518559/>, (5.4.2018)

30. Z. Millaku (Kryeprokuror) i njoftoi përfaqësuesit e Avokatit të Popullit se më datë 27, respektivisht 28 shkurt 2018, Prokuroria Speciale ka pranuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë, dy kërkesa nga Ministria e Drejtësisë së Turqisë, për ekstradimin e dy personave, të cilat janë përcjellë nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës, me një shkresë përcjellëse, fillimisht, gabimisht - sipas z. Millaku, tek Gjykata Themelore në Prishtinë, më datë 26 shkurt 2018.
31. Sipas z. Millaku, nga shkresat e lëndës, shihet se Ministria e Drejtësisë së Turqisë, nëpërmjet Ambasadës së saj në Prishtinë, ia ka përcjellë Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës, kërkesën për ekstradimin e dy shtetasve turq (z. Kahraman Demirez dhe z. Yusuf Karabina) me qëndrim në Kosovë, lidhur me dyshimet për kryerjen e veprës penale për terrorizëm. Gjithmonë sipas z. Millaku, këto kërkesa, të shoqëruara secila prej tyre me shkresë përcjellëse të Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës kanë arritur në Prokurorinë Speciale dhe kërkesa tjera nuk ka pasur.
32. Sipas z. Millaku, ata veprojnë në këto raste bazuar në Ligjin për Bashkëpunimin Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale. Ata kanë parë kërkesat, por kanë pasur për bazë dispozitat ligjore të këtij Ligji, në të cilat parashihen rastet kur iniciohet procedura për ekstradim dhe rastet kur ekstradimi nuk lejohet. Sipas z. Millaku, duke e pasur të njohur publikisht situatën e të drejtave të njeriut në Turqi dhe po ashtu përshkrimin ligjor se në cilat raste nuk lejohet ekstradimi i të huajve, ata nuk kanë vepruar.
33. Më 6 prill 2018, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit, së bashku me zyrtarët e Zyrës së Komisionerit të Lartë të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut u takuan me familjarët e shtetasve turq të larguar me forcë nga territori i Republikës së Kosovës.

Procedurat pranë Policisë së Kosovës

34. Avokati i Popullit, nga dokumentet e pranuar vëren se Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës më 29 mars 2018 ka lëshuar Urdhër për Largim me Forcë bazuar në nenin 6, 97 dhe 99, paragrafi 2 i Ligjit për të Huajt nr. 04/L-2019 dhe nenin 8 paragrafi 1 i Udhëzimit Administrativ (MPB) nr. 09/2014 për Kthimin e të Huajve me Qëndrim të Paligjshëm në Republikën e Kosovës.
35. Në arsyetimin për secilin Urdhër për Largim me Forcë, qëndrojnë arsyet e njëjta. Në secilin vendim theksohet se: *..[qëndrimi i tij i mëtejme në Republikën e Kosovës mund të paraqet kërcënim që lidhet me sigurinë shtetërore dhe rendin publik...].*
36. Në të njëjtat vendime theksohet se ky akt mund të kundërshtohet me ankesë në Komisionin për Shqyrtim të Ankesave për të huajt brenda 8 (tetë) ditëve nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet personalisht apo nëpërmjet të autorizuarit juridik. Po ashtu në vendim shprehimisht theksohet se ankesa nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Instrumentet ligjore të zbatueshme në Republikën e Kosovës

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

37. Të drejtat dhe liritë themelore garantohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, si akti më i lartë juridik dhe politik. Një numër i konventave ndërkombëtare relevante për mbrojtjen

e të drejtave të njeriut janë inkorporuar në nenin 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovë dhe në rast konflikti kanë epërsi ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike në Republikën e Kosovës.⁶

38. Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin 27 shprehimisht përcakton:

*“Askush nuk i nënshtrohet torturës, ndëshkimit a trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues”.*⁷

39. Ndërsa neni 29 (E drejta e lirisë dhe sigurisë), përcakton si në vijim:

1. Secilit i garantohet e drejta e lirisë dhe sigurisë. Askush nuk mund të privohet nga liria me përjashtim të rasteve të parapara me ligj dhe me vendim të gjykatës kompetente, si në vijim:

(1) pas shpalljes së dënimit me burgim për kryerjen e veprës penale;

(2) për dyshim të bazuar për kryerje të veprës penale, vetëm kur privimi nga liria me një bazë të arsyeshme konsiderohet i domosdoshëm për të parandaluar kryerjen e një vepre tjetër penale dhe vetëm për një periudhë të shkurtër kohore para gjykimit në mënyrën e përcaktuar me ligj;

(3) për mbikëqyrjen e të miturit për qëllime edukimi ose për shoqërimin e tij/saj në një institucion kompetent, sipas një urdhri të ligjshëm;

(4) për mbikëqyrje shëndetësore të personit, i cili për shkak të sëmundjes paraqet rrezik për shoqërinë;

(5) për hyrje të paligjshme në Republikën e Kosovës ose pas urdhrit të ligjshëm për largim ose ekstradim.

40. Neni 29, paragrafi 2 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës shprehimisht përcakton:

“Çdokush që privohet nga liria, duhet të vihet në dijeni menjëherë, për arsyet e privimit, në gjuhën që ajo/ai e kupton. Njoftimi me shkrim mbi arsyet e privimit duhet të bëhet sa më shpejt që të jetë e mundur. Çdokush që privohet nga liria pa urdhër të gjykatës, brenda dyzet e tetë (48) orësh duhet të dërgohet përpara gjyqtarit, i cili vendos për paraburgimin ose lirimin e tij/saj, jo më vonë se dyzet e tetë (48) orë nga momenti kur personi i privuar është sjellë para gjykatës. Çdokush që arrestohet, ka të drejtën që të nxirret në gjykim brenda një periudhe të arsyeshme, ose të lirohet në pritje të gjykimit, me përjashtim kur gjyqtari konstaton se personi përbën rrezik për komunitetin ose ka rrezik për ikjen e saj/tij para gjykimit”.

41. Neni 29 paragrafi 3: *“Çdokush që privohet nga liria, duhet të njoftohet menjëherë se ka të drejtë të mos japë asnjë deklaratë dhe se ka të drejtë për mbrojtës sipas zgjedhjes së tij/saj dhe ka të drejtë që pa vonesë të informojë për këtë personin sipas zgjedhjes së vet”.*

42. Neni 29, paragrafi 4: *“Çdokush që i hiqet liria me arrest ose ndalim, gëzon të drejtën që të përdorë mjete juridike për të sfiduar ligjshmërinë e arrestit ose të ndalimit. Rasti do të vendoset nga gjykata brenda një afati sa më të shkurtër dhe nëse arresti ose ndalimi është i paligjshëm, do të urdhërohet lirimi i personit”.*

⁶ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 22.

⁷ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 27.

43. Neni 29, paragrafi 5: “Çdokush që është ndaluar ose arrestuar në kundërshtim me dispozitat e këtij neni, gëzon të drejtën e kompensimit në mënyrën e parashikuar me ligj”.
44. Neni 29, paragrafi 6: “Personi që vuan dënimin, ka të drejtë të ankohet për kushtet e privimit nga liria, në mënyrën e përcaktuar me ligj”.
45. Neni 30 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës garanton të drejtat e personave të akuzuar. Sipas këtij neni, personat e akuzuar kanë të drejta si në vijim:
- (1) të njoftohet menjëherë në gjuhën që kupton, për natyrën dhe shkakun e akuzës kundër saj/tij;
 - (2) të njoftohet për të drejtat e tij/saj sipas ligjit;
 - (3) të ketë kohë, mundësi dhe mjete të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e vet;
 - (4) të ketë ndihmën pa pagesë të një përkthyesi, kur nuk flet ose nuk kupton gjuhën në të cilën zhvillohet gjykimi;
 - (5) të ketë ndihmën e një mbrojtësi që e zgjedh, të komunikojë lirisht me të dhe, nëse nuk ka mjete të mjaftueshme, t’i sigurohet mbrojtja falas;
 - (6) të mos shtrëngohet për të dëshmuar kundër vetvetes ose për të pranuar fajësinë e vet.
46. Po ashtu, Kushtetuta e Republikës së Kosovës mbron të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, si dhe të drejtën për mjete juridike.⁸

Ligji nr. 04/L-219 për të Huajt

47. Qëllimi i këtij ligji është rregullimi i hyrjes, lëvizjes, qëndrimit dhe punësimit të të huajve në territorin e Republikës së Kosovës.⁹ Shtetasit turq të dëbuar nga territori i Republikës së Kosovës ishin të pajisur me leje qëndrimi të përhershme dhe të përkohshme.
48. Neni 91 i Ligjit nr. 04/L-219 për të Huajt parasheh situata kur të huajt i revokohet leje qëndrimi. Sipas këtij neni leja e qëndrimit të huajve u revokohet nëse: *ka ndalesë për hyrje dhe qëndrim në Republikën e Kosovës, qëndron jashtë Republikës së Kosovës më shumë se një (1) vit; konstatohet se me vetëdije ka dhënë informacion të rremë ose i ka fshehur me vetëdije qëllimet dhe rrethanat që ishin me rëndësi për qëndrim të përhershëm; paraqet rrezik për rendin publik, sigurinë shtetërore apo shëndetin publik; nëse këtë e bënë me kërkesën e tij.*
49. Më tej në paragrafi 2 të nenit 91 shprehimisht theksohet se organi kompetent për nxjerrjen e vendimit për revokim të leje qëndrimit është DSHAM. Ndërsa sipas paragrafit 3 të këtij neni, vendimi për revokimin e leje qëndrimit të përhershëm mund të lëshohet pa dëgjimin e të huajit.
50. **Kundër vendimit për revokim të leje qëndrimit të përhershëm nuk lejohet ankesë, por mund të iniciohet konflikt administrativ në Gjykatën Themelore.**¹⁰
51. Neni 98 i Ligjit nr. 04/L-219 për të Huajt përcakton mënyrën dhe institucionin të cilit i huaji subjekt i urdhrit për largim me forcë mund t’i drejtojë ankesë. Sipas paragrafit 1 të këtij neni: “I huaji ka të drejtë ankese brenda tetë (8) ditëve, pas pranimit të urdhër largimit me forcë te

⁸ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 31 [E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm]. Neni 32 [E drejta për mjete juridike].

⁹ Ligji nr. 04/L-219 për të Huajt, neni 1.

¹⁰ Ligji nr. 04/L-219 për të Huajt, neni 91, paragrafi 4.

Komisioni i Ankesave. Komisioni duhet ta zgjidh çështjen brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit të ankesës. Ankesa kundër vendimit lidhur me urdhrin për largim me forcë, nuk e pezullon ekzekutimin e urdhër largimit me forcë”.

52. Në paragrafi 2 të po këtij neni shprehimisht theksohet: “Në rastet kur i huaji është i pakënaqur me vendimin e Komisionit të ankesave atëherë ai mund të hap konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore, brenda tetë (8) ditëve nga marrja e vendimit. Gjykata duhet të zgjidh çështjen nga ky paragraf brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditëve nga dita e pranimit të padisë”.

Procedurat e zbatimit të urdhrin të dëbimit

53. Neni 99 i Ligjit për të Huajt përcakton se DSHAM është departamenti kompetent i cili jep urdhrin e dëbimit, ndërsa ky urdhër zbatohet nga Policia Kufitare e cila në kuptim të këtij neni të Ligjit për të Huajt ndërmerr masat në vijim: *merr masa për ndalimin e të huajit në Qendrën e Mbajtjes, ose zbatimin e masave të përkohshme të përcaktuara në këtë ligj, derisa të zbatohet urdhër dëbimi; merr shenjat e gishtërinjve dhe të pëllëmbës së dorës të të huajit, fotografinë dhe shenjat biometrike; regjistron urdhrin për dëbim në bazat përkatëse të të dhënave, ku shënohet periudha e ndalimit të hyrjes në Republikën e Kosovës dhe pikën e kalimit kufitar të largimit të të huajit; inicicion pranë institucioneve përgjegjëse marrjen e masave të parapara për pajisje me fletudhëtim, sigurimin e kthimit në vendin e origjinës dhe biletën e udhëtimit.*
54. Ndërsa, në paragrafit 2 të nenit 99 të Ligjit për të Huajt, shprehimisht përcaktohet se Urdhri i dëbimit zbatohet menjëherë, në rast se prania e të huajit përbën kërcënim për rendin dhe sigurinë shtetërore.
55. **Siç u theksua edhe në paragrafin 9 të këtij raporti, në ditën e arrestimit dhe dëbimit të shtetasve turq Avokati i Popullit u njoftua se ata nuk ishin dërguar në Qendrën e Mbajtjes për të Huajt.**

Ligji nr. 04/L-213 për Bashkëpunim Ndërkombëtarë Juridik në Çështje Penale

56. Neni 18 i Ligjit nr. 04/L-213 për Bashkëpunim Ndërkombëtarë Juridik në Çështje Penale parasheh se procedura për ekstradim fillon në bazë të kërkesës me shkrim drejtuar Ministrisë.
57. Neni 1 i këtij Ligji shprehimisht përcakton qëllimin e ligjit: “Ky ligj rregullon kushtet dhe procedurat për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështje penale mes Republikës së Kosovës dhe shteteve të tjera, në qoftë se nuk është përcaktuar ndryshe me marrëveshje ndërkombëtare”.
58. Më tej, në nenet 14, 15, 16 dhe 17 ligji shprehimisht përcakton rastet kur nuk lejohet ekstradimi. Neni 14 paragrafi 1 shprehimisht përcakton: “Ekstradimi refuzohet kur vepra penale për të cilën paraqitet kërkesa është vepër penale politike apo vepër e cila është e ndërlidhur me vepër penale politike”.
59. Neni 15: “Ekstradimi nuk lejohet për vepra penale sipas ligjit penal ushtarak të cilat nuk janë vepra penale sipas ligjit penal”.
60. Neni 16 paragrafi 1 (Dënimi me vdekje dhe burgim të përjetshëm): “Ekstradimi nuk lejohet për vepra penale të dënueshme me dënim me vdekje sipas ligjit të shtetit kërkues, përveç nëse

shteti kërkues jep garanci që konsiderohen të mjaftueshme se dënimi me vdekje nuk do të shqiptohet apo të ekzekutohet”.

61. Neni 16 paragrafi 2: *“Ekstradimi mund të mos lejohet nëse vepra mbi të cilën është bazuar kërkesa sipas ligjit të Shtetit kërkues është e dënueshme me burgim të përjetshëm apo një dënim tjetër të përjetshëm ose në qoftë se personi i kërkuar është dënuar me dënim të tillë dhe nuk ka asnjë rishikim të dënimit me vdekje apo dënimit me burgim me kërkesë apo proprio motu pas një periudhe jo më të gjatë se njëzet (20) vite”.*
62. Neni 17 shprehimisht parasheh rastet kur refuzohet ekstradimi bazuar në klauzolën jo diskriminuese dhe standardet e të drejtave të njeriut. Paragrafi 1 i këtij neni përcakton: *“Ekstradimi i një personi të kërkuar nuk lejohet nëse ekziston dyshimi i arsyeshëm se kërkesa është bërë për qëllime të ndjekjes penale ose të ndëshkimit për shkak të racës, fesë, gjinisë, shtetësisë, bindjes politike, etnisë, gjuhës, aftësisë së kufizuar, orientimit seksual, anëtarësisë të tij apo saj në ndonjë grup shoqëror, apo nëse pozita e tij apo saj në shoqëri mund të paragjykohet për njërin nga këto arsye”.*
63. Neni 17 paragrafi 2 ndalon ekstradimin: *“nëse ekzistojnë shkaqe të arsyeshme se personi i kërkuar mund t'i nënshtrohet torturës apo trajtimit mizor, çnjerëzor, poshtërues ose ndëshkimit”.*
64. Neni 17 paragrafi 3: *“Ekstradimi nuk lejohet nëse ka arsye për të besuar se personi nuk do të pranojë garancitë minimale për një gjykim të drejtë në shtetin kërkues, siç parashihet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës”.*
65. Ndërsa neni 17 paragrafi 6 shprehimisht përcakton: *“Ekstradimi nuk lejohet për çfarëdo arsye tjetër të bazuar që do të paraqiste shkelje të së drejtës ndërkombëtare ose standardeve tjera të të drejtave të njeriut”.*

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut

66. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, e miratuar nga Asambleja e Kombeve të Bashkuara në vitin 1948 është një nga instrumentet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut e cila është përfshirë në nenin 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Neni 5 i kësaj deklarate shprehimisht përcakton: *“Askush nuk duhet t'i nënshtrohet torturës, veprimet ose dënimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues”.*
67. Neni 8 përcakton: *“Gjithkush ka të drejtë për mjete juridike efektive para gjykatave kompetente kombëtare për veprimet me të cilat shkelen të drejtat themelore të garantuara nga kushtetuta ose ligjet”.*
68. Neni 9: *“Asnjëri nuk duhet t'i nënshtrohet arbitrarisht arrestimit, ndalimit ose dëbimit”.*
69. Neni 10: *“Gjithkush gëzon njëlloj të drejtën për një proces gjyqësor objektiv e publik para një gjykate të pavarur e të paanshme, në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të veta dhe për vendimin mbi çfarëdo lloj akuze penale”.*

Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve a Dënimeve të Tjera Mizore Çnjerëzore ose Poshtëruese

70. Neni 3 paragrafi 1: *“Asnjë shtet palë nuk do të dëbojë, nuk do të prapësojë, e as nuk do të*

ekstradojë një person në një shtet tjetër ku ka arsye serioze për të besuar sa ai rrezikon t'i nënshtrohet torturës”.

71. Neni 3 paragrafi 2: *“Me qëllim të përcaktimit nëse ekzistojnë arsye të tilla, autoritetet kompetente do të marrin parasysh të gjitha rrethanat përkatës e duke përfshirë, kudo që është e zbatueshme, ekzistimin e një vistrë dhunimesh sistematike, të rënda, flagrante ose masive të të drejtave të njeriut në një shtet përkatës“.*

Pakti Ndërkombëtarë për të Drejtat Civile dhe Politike

72. Pakti Ndërkombëtarë për të Drejtat Civile dhe Politike, po ashtu është një nga instrumentet e rëndësishme ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe i cili është i inkorporuar në nenin 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe pjesë e sistemit ligjor dhe kushtetues të vendit.

73. Në nenin 7 të këtij pakti shprehimisht përcaktohet se: *“Askush nuk duhet t'i nënshtrohet torturës dhe as dënimeve ose trajtimeve mizore, çnjerëzore e poshtëruese. Në veçanti, askush nuk duhet t'i nënshtrohet një eksperimenti mjekësor ose shkencor pa pëlqimin e tij të lirë”.*

74. Neni 9 paragrafi 1: *“Secili ka të drejtën e lirisë dhe të sigurisë së personit të tij. Askush nuk duhet të jetë objekt i një arrestimi ose burgimi arbitrar. Askush nuk duhet të privohet nga liria, përveç për arsye dhe në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj”.*

75. Neni 9, paragrafi 2: *“Çdo person i arrestuar duhet të informohet, në çastin e arrestimit, për arsyet e arrestimit dhe menjëherë duhet të njoftohet lidhur me çdo akuzë që bëhet kundër tij”.*

76. Neni 13: *“Një i huaj që ndodhet ligjërisht në territorin e një shteti palë të këtij Pakti mund të dëbohet nga ai shtet vetëm sipas vendimit të marrë në bazë të ligjit dhe me përjashtim të rasteve kur arsyet e forta lidhur me sigurinë kombëtare nuk e lejojnë një gjë të tillë, atij duhet t'i jepet mundësia të parashtrij arsyet kundër dëbimit të tij dhe të kërkoj shqyrtimin e çështjes së tij nga një organ kompetent ose nga një a më shumë persona të caktuar posaçërisht nga ky organ, duke qenë i përfaqësuar aty edhe ai vetë”.*

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Protokollat e saj

77. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm “KEDNJ”), si një nga instrumentet më të rëndësishme ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, po ashtu është pjesë e sistemit kushtetues dhe ligjor në Republikën e Kosovës dhe ka prioritet në raport me dispozitat e ligjeve dhe akteve të miratuara nga institucionet publike në Republikën e Kosovës.

78. Neni 5, paragrafi 2 i KEDNJ shprehimisht përcakton: *“Çdo person i arrestuar duhet të informohet brenda një afati sa më të shkurtër dhe në një gjuhë që ai e kupton për arsyet e arrestimit të tij dhe në lidhje me çdo akuzë që i bëhet”.*

79. Neni 3 i KEDNJ: *“Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës ose dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese”.*

80. Neni 1 paragrafi 1 i Protokollit 7 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore shprehimisht përcakton:

1. Një i huaj me qëndrim të rregullt në territorin e një Shteti nuk mund të dëbohet, veçse në

zbatim të një vendimi të marrë në përputhje me ligjin dhe duhet të ketë mundësi:

- (a) të parashtrorjës arsyt kundër dëbimit të tij,
- (b) të kërkojë shqyrtimin e çështjes së tij, dhe
- (c) të përfaqësohet për këto qëllime përpara autoritetit kompetent ose një ose disa persona të caktuar nga ky autoritet.

Vlerësimi i Avokatit të Popullit

- 81. Avokati i Popullit vëren se në rastin e tanishëm autoritet kompetente ndërmorën veprime për të larguar me forcë të huajt në fjalë pa koordinime në mes të institucioneve në bazë të mandateve të cilat i kanë, si dhe me mungesë transparence e cila është parimi kryesor i mirëqeverisjes në një vend.
- 82. Nga informatat e grumbulluara deri më tani është e qartë se personat në fjalë u larguan me forcë nga territori i Republikës së Kosovës për t'u dorëzuar tek autoritetet policore turke të cilat menjëherë i arrestuan dhe i akuzuan për kryerjen e veprës penale të terrorizmit.
- 83. Sipas nenit 3.1.26 të Ligjit nr. 04/L-219 për të Huajt largimi me forcë definohet si “ekzekutim i obligimit për tu kthyer, përkatësisht transportim fizik jashtë Republikës së Kosovës”.
- 84. Po ashtu, nga takimi i përfaqësuesve të avokatit të Popullit me Kryeprokurorin e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës del se Prokuroria Speciale ka pranuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë, dy kërkesa nga Ministria e Drejtësisë së Turqisë, për ekstradimin e dy personave të cilët u ekstraduan së bashku me të tjerët, të cilat janë përcjellë nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës, me një shkresë përcjellëse, më datë 26 shkurt 2018.
- 85. Më tej, sipas Kryeprokurorit, Ministria e Drejtësisë së Turqisë, nëpërmjet Ambasadës së saj në Prishtinë, ia ka përcjellë Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës, kërkesën për ekstradimin e dy shtesave turq (z. Kahraman Demirez dhe z. Yusuf Karabina) me qëndrim në Kosovë, lidhur me dyshimet për kryerjen e veprës penale për terrorizëm.
- 86. Avokati i Popullit vlerëson se në raste të tilla, është dashur të zbatohen procedurat e ekstradimit të parapara me Ligjin nr. 04/L-213 për Bashkëpunim Ndërkombëtarë Juridik në Çështje Penale. Në këtë ligj, precizohen qartë procedurat, obligimet dhe veprimet të cilat mund dhe duhet t'i ndërmarrin organet kompetente deri në vendimin për të ekstraduar një person bazuar në kërkesën e parashtruar nga shteti tjetër.
- 87. Në këtë mënyrë të dëbuarve iu mohuan të drejtat për t'u dëgjuar dhe gjykuar nga organi kompetent publik. Kjo e drejtë po ashtu garantohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, Konventën Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore, Protokollat e saj shtesë, Paktin për të Drejtat Civile dhe Politike, si dhe me vetë praktikën gjyqësore të GJEDNJ. Të gjitha këto instrumente ndërkombëtare janë pjesë e sistemit kushtetues dhe ligjor të Republikës së Kosovës dhe kanë epërsi ndaj dispozitave dhe ligjeve vendore në rast konflikti.
- 88. Në ditën e arrestimit, organi kompetent i mandatuar për të privuar personat nga liria, Policia e Kosovës, nuk ishte në gjendje apo nuk donte të jap informacione konkrete se ku ndodheshin personat për të cilët mediat e shkruara dhe elektronike raportuan se janë arrestuar. Madje, një

informatë e tillë iu mohua edhe Avokatit të Popullit, mandati i të cilit është mbrojtja e të drejtave dhe lirive themelore, sidomos e personave të arrestuar të cilët konsiderohen kategori e cenueshme meqenëse me rastin e arrestimit ata janë plotësisht nën kontroll të autoriteteve.

89. Po ashtu, në ditën e arrestimit, personave të dëbuar iu mohuan plotësisht të drejtat themelore të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Ligjin për Policinë, si dhe të gjitha standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të personave të arrestuar. Këto të drejta janë: e drejta për të pasur një avokat, e drejta për të pasur një mjek, si dhe e drejta për të njoftuar familjen apo personin sipas dëshirës për faktin se janë privuar nga liria. Këto të drejta konsiderohen garanci themelore kundër keqtrajtimit fizik.
90. Edhe Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, në standardet e përcaktuara, këto të drejta themelore i konsideron si garanci kryesore kundër keqtrajtimit fizik të personave të arrestuar.¹¹
91. Mohimi i plotë i këtyre të drejtave e vë personin e arrestuar në rrezik nga ushtrimi i torturës apo keqtrajtimit fizik. Në ditën e arrestimit, as avokatët mbrojtës dhe as familjarët e të arrestuarve nuk u njoftuan për vend ndodhjen e personave të arrestuar.
92. Vendimet për largimin me forcë nga territori i Republikës së Kosovës dhe revokim të lejeve të qëndrimit nuk iu dorëzuan personave të larguar me forcë dhe avokatëve mbrojtës të tyre. Avokati i Popullit rithekson si edhe në rastet tjera, se mohimi i të drejtës në ushtrim të mjeteve juridike është shkelje e rëndë e të drejtave të njeriut e cila garantohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ligjet në fuqi dhe të gjitha standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ)

93. Neni 53 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcakton: *“Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”*.
94. GJEDNJ shprehimisht dhe qartë ka theksuar se shtetet në asnjë rrethanë nuk mund të dëbojnë një të huajë në territorin e një shteti ku ai mund t’i ekspozohet rrezikut për t’u torturuar dhe keqtrajtuar fizikisht. Gjykata theksoi se kjo ndalesë në nenin 3 të Konventës është e karakterit absolut dhe zbatohet edhe *“në kohë lufte apo emergjencash tjera publike të cilat kërcënojnë kombin”*.
95. Po ashtu, në rastin **Saadi kundër Italisë** Dhoma e Madhe e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut njëzëri riafirmojë karakterin absolut të ndalimit të torturës, trajtimit çnjerëzor dhe degradues apo ndëshkimit të garantuar me nenin 3 të KEDNJ. Në rastin në fjalë, GJEDNJ vendosi se vendimi i qeverisë italiane për të deportuar të dyshuarin për terrorizëm në Tunizi, ku ai do të ballafaqohej me rrezikun real të torturës, do të përbënte shkelje të nenit 3 të KEDNJ.¹²

¹¹ Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Raporti i 2-të i Përgjithshëm, publikuar në vitin 1992, në: <https://rm.coe.int/16806cea2f>, (5.4.2018)

¹² Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Dhoma e Madhe, **Saadi k. Italisë**, Application no. [37201/06](https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22respondent%22:%5B%22ITA%22%5D,%22documentcollectionid%22:%5B%22GRA%22%5D%7D), 28 shkurt 2008, në: <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22respondent%22:%5B%22ITA%22%5D,%22documentcollectionid%22:%5B%22GRA%22%5D%7D>

96. Pavarësisht, ndalesës në nenin 15(2) të KEDNJ të çdo derogimi nga neni 3, vendimi i Gjykatës është i rëndësishëm në kuptim të pretendimeve të disa shteteve që nga ngjarjet e shtatorit 2001, se si rezultat i përpjekjeve për të siguruar një ambient më të sigurt për qytetarët dhe për ta luftuar terrorizmin ndërkombëtarë, mbrojtja e disa të drejtave themelore do të duhej të balancohej në raport me shqetësimet për siguri kombëtare.
97. Gjykata hodhi poshtë këto pretendime dhe fuqishëm riafirmojë parimin se në asnjë rrethanë, përfshirë edhe kërcënimin e terrorizmit, nuk mund të justifikohet ekspozimi i një individi rrezikut serioz, të shkeljeve të të drejtave të njeriut.
98. Në rastin *Chahal v. Mbretërisë së Bashkuar*, në të cilin shteti deportues pretendonte se i deportuari përbënte rrezik për sigurinë kombëtare dhe se duhej deportuar në Indi, GJEDNJ vlerësoi se interesat e sigurisë së shtetit nuk mund të merren në konsiderim, në përcaktimin nëse shteti palë nënshkruese e ka shkelur konventën.¹³ Gjykata me këtë rast konstatoi se ndalesa në nenin 3 kundër torturës, trajtimit çnjerëzor dhe poshtërujes apo ndëshkimit, për dallim nga nenet tjera, është e karakterit absolut. Për më shumë, ndalesa në nenin 3, sipas GJEDNJ, zbatohet edhe “*në kohë lufte apo emergjencash tjera publike të cilat kërcënojnë kombin*”.
99. Gjatë vendosjes në rastin në fjalë, GJEDNJ mori parasysh raportet ndërkombëtare për gjendjen e të drejtave të njeriut në Indi ku personi në fjalë do të deportohej. Në raportin e Raportuesit Special kundër Torturës të vitit 1995 për Indinë, theksohej: “*Është e qartë se disa incidente, për çka besohet në mënyrë të besueshme se është fjala për fenomen të përhapur, nëse jo diçka endemike, ndiqen penalisht dhe disa të tjera qojnë në dënim të kryerësve. Vlen të theksohet se shumë raste të cilat sillen në vëmendje të Raportuesit Special janë ato raste të cilat rezultojnë në vdekje, me fjalë tjera, raste në të cilat mund të jetë zbatuar tortura me rezultatet më ekstreme.*”¹⁴
100. Po ashtu, Gjykata mori parasysh raportin e Departamentit të Shtetit të SHBA për të drejtat e njeriut në Indi ku thekson shkelje dhe persekutime të ndryshme që u bëheshin militantëve Sikh.¹⁵
101. Neni 100 i Ligjit nr. 04/L-219 për të Huajt parasheh rastet kur i huaji nuk dëbohet nga territori i Republikës së Kosovës. Një ndër këto raste është edhe ekzistimi i dyshimit të

[NDCHAMBER%22.%22CHAMBER%22.%22DECGRANDCHAMBER%22\],%22violation%22:\[%223%22\],%22itemid%22:\[%22001-85276%22\]}}](#), (4.4.2018)

¹³ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Chahal k. Mbretërisë së Bashkuar*, Application no. [22414/93](#), 15 nëntor 1996, në:

[https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22fulltext%22:\[%22chahal%22\],%22respondent%22:\[%22GBR%22\],%22documentcollectionid%22:\[%22GRANDCHAMBER%22,%22CHAMBER%22\],%22violation%22:\[%223%22\],%22itemid%22:\[%22001-58004%22\]}}](https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22fulltext%22:[%22chahal%22],%22respondent%22:[%22GBR%22],%22documentcollectionid%22:[%22GRANDCHAMBER%22,%22CHAMBER%22],%22violation%22:[%223%22],%22itemid%22:[%22001-58004%22]}}), (4.4.2018)

¹⁴ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Chahal k. Mbretërisë së Bashkuar*, Application no. [22414/93](#), 15 nëntor 1996, paragrafi 51, në:

[https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22fulltext%22:\[%22chahal%22\],%22respondent%22:\[%22GBR%22\],%22documentcollectionid%22:\[%22GRANDCHAMBER%22,%22CHAMBER%22\],%22violation%22:\[%223%22\],%22itemid%22:\[%22001-58004%22\]}}](https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22fulltext%22:[%22chahal%22],%22respondent%22:[%22GBR%22],%22documentcollectionid%22:[%22GRANDCHAMBER%22,%22CHAMBER%22],%22violation%22:[%223%22],%22itemid%22:[%22001-58004%22]}}), (4.4.2018)

¹⁵ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Chahal k. Mbretërisë së Bashkuar*, Application no. [22414/93](#), 15 nëntor 1996, paragrafi 53, në:

[https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22fulltext%22:\[%22chahal%22\],%22respondent%22:\[%22GBR%22\],%22documentcollectionid%22:\[%22GRANDCHAMBER%22,%22CHAMBER%22\],%22violation%22:\[%223%22\],%22itemid%22:\[%22001-58004%22\]}}](https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22fulltext%22:[%22chahal%22],%22respondent%22:[%22GBR%22],%22documentcollectionid%22:[%22GRANDCHAMBER%22,%22CHAMBER%22],%22violation%22:[%223%22],%22itemid%22:[%22001-58004%22]}}), (4.4.2018)

bazuar se i huaji, në vendin e origjinës apo në një vend tjetër, do të dënohet me vdekje, do t'i nënshtrohet torturës, trajtimit çnjerëzor e degradues apo dënimeve për shkaqe diskriminuese.

102. Por, Avokati i Popullit vëren se paragrafi 2 i nenit 100 të Ligjit nr. 04/L-219 për të Huajt, e privon të huajin nga garancia për të mos u dëbuar në një shtet ku ai mund t'i nënshtrohet torturës, keqtrajtimit fizik dhe kufizimit serioz të të drejtave tjera, duke u thirrur në arsyet të sigurisë kombëtare. Ky paragraf shprehimisht përcakton:

“Përjashtimisht, i huaji mund të dëbohet, edhe pse përmbushen kushtet e përmendura në paragrafin 1. të këtij neni, në qoftë se qëndrimi i tij rrezikon rendin dhe sigurinë publike, si dhe përbën kërcënim për sigurinë shtetërore”.

103. Avokati i Popullit vlerëson se kjo dispozitë e Ligjit nr. 04/L-219 për të Huajt krijon mjaftë hapësirë për veprime arbitrare të shtetit dhe nuk është në harmoni me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe instrumentet tjera ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të cilat janë pjesë e sistemit ligjor dhe kushtetues në vendin ton, si dhe me praktikën gjyqësore të GJEDNJ.
104. Avokati i Popullit është i mendimit se autoritetet e Republikës së Kosovës të cilat dëbuan të huajt në fjalë nuk kanë bërë fare një vlerësim se cilat janë garancitë kundër keqtrajtimit fizik dhe torturës në shtetin e tyre të origjinës, pra në Turqi.

Raportet e Organizatave Ndërkombëtare për Situatën e të Drejtave të Njeriut në Turqi

Raporti i “Amnesty International” 2017/2018¹⁶

105. Avokati i Popullit vëren se në këtë raport *Amnesty International* raporton se gjendja e shtetrrëthimit e deklaruar në vitin 2016 pas tentimit të grusht shtetit, ka krijuar një sfond për shkelje të të drejtave të njeriut. Sipas *Amnesty International*, kundërshtimi shtypet pa mëshirë në rastin e gazetarëve, aktivistëve politik dhe mbrojtësve të të drejtave të njeriut, raste të ushtrimit të torturës vazhdojnë të raportohen por më pak se në javët e para të tentimit të grusht shtetit në korrik të vitit 2016.
106. *Amnesty International* më tej thekson se hetimi efektiv i shkeljeve të të drejtave të njeriut është parandaluar për shkak të pandëshkueshmërisë së përhapur. Gjendja e jashtëzakonshme e shpallur pas tentimit të grusht shtetit e shtroi rrugën për kufizime të kundërligjshme të të drejtave të njeriut dhe i lejoi qeverisë miratimin e ligjeve pa iu nënshtruar mbikëqyrjes parlamentare dhe gjyqësore.
107. Po sipas këtij raporti, mbi 50.000 njerëz po mbaheshin në paraburgim nën akuza të ndërlidhura me anëtarësimin në organizatën FETÖ, të cilën autoritetet turke e fajësojnë për tentim grusht shteti në vitin 2016. Raporti thekson shkelje serioze të lirisë së shprehjes, paraburgosje të mbi 100 gazetarëve, burgosje të 10 mbrojtësve të të drejtave të njeriut, shkelje të së drejtës së lirisë së tubimeve publike.
108. Bazuar në dekretet për gjendje të jashtëzakonshme, të punësuarit në sektorin publik

¹⁶ Amnesty International Report 2017/2018, Turkey, në:
<https://www.amnesty.org/download/Documents/POL1067002018ENGLISH.PDF>, (4.4.2018)

përballen me shkarkimet në masë, bazuar në pohime për lidhje të paspecifikuara me grupet terroriste. Afër 20,000 të punësuar janë përjashtuar nga puna gjatë vitit duke rritur kështu numrin e të larguarve nga puna në sektorin publik në korrik të vitit 2016 në 107,000.

109. Më tej, *Amnesty International* shpreh shqetësimin serioz për faktin se autoritetet turke ende po refuzojnë publikimin e raportit të Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës për vizitën në Turqi në vitin 2016 dhe 2017.¹⁷
110. *Amnesty International* po ashtu thekson se nuk ka një Mekanizëm Kombëtar Parandalues efektiv i cili ka mandat për të monitoruar vendet ku mbahen personat e privuar nga liria. Sipas raportit nuk kishte statistika lidhur me hetimet e pohimeve për ushtrim të torturës dhe nuk kishte dëshmi se këto pohime po hetoheshin në mënyrë efektive.

Zyra e Komisionerit të Lartë të OKB për të Drejtat e Njeriut

Raporti për ndikimin e gjendjes së jashtëzakonshme në të drejtat e njeriut në Turqi për periudhën janar-dhjetor 2017¹⁸

111. Në raportin e Komisionerit të Lartë të OBS-së për të Drejtat e Njeriut lidhur me ndikimin e gjendjes së jashtëzakonshme në Turqi në të drejtat e njeriut, për periudhën janar/dhjetor 2017, në paragrafin 2 të përmbledhjes ekzekutive theksohet: “*Zyra e Komisionerit të Lartë të OKB-së për të Drejtat e Njeriut njih situatën komplekse me të cilën Turqia është përballur duke e adresuar tentimin për grusht shtet të datës 15 korrik 2016. Megjithatë, Zyra e Komisionerit të Lartë është seriozisht e shqetësuar për shkak të efekteve të kundërta në gëzimin e të drejtave të njeriut si pasojë e masave të shumta të ndërmarra pas deklarimit të gjendjes së jashtëzakonshme*”.
112. Më tej në paragrafin 3 të raportit theksohet se më 21 korrik 2016, Qeveria e Turqisë e njoftoi Sekretarin e Përgjithshëm të OKB-së për derogimin e disa prej obligimeve të saj të cilat burojnë nga nënshkrimi i Paktit për të Drejtat Civile dhe Politike, respektivisht nga nenet 2, 3, 9, 10, 12, 13, 14, 17, 19, 21, 22, 25, 26 dhe 27.
113. Sipas këtij raporti, më 21 korrik 2016, u shpallen dekretet për gjendje të jashtëzakonshme, duke anashkaluar mbikëqyrjen parlamentare dhe duke shmangur edhe ankesën pranë Gjykatës Kushtetuese. Në paragrafin 7 të raportit theksohet: “*Informatat e besueshme të mbledhura nga Zyra e Komisionerit të Lartë të OKB-së, flasin për ndërhyrje të pushtetit ekzekutiv në punën e gjyqësorit, kufizim të mbikëqyrjes parlamentare mbi degën ekzekutive të Qeverisë; shkarkim masiv arbitrarë të nëpunësve civil dhe të punësuarve në sektorin privat; mbyllje arbitrare të organizatave të shoqërisë civile; përfshirë mbylljen e Organizatave të njohura Jo-Qeveritare për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe mediave; arrestime arbitrare të njerëzve bazuar në masat e ndërmarra si pasojë e gjendjes së jashtëzakonshme; përdorim të torturës dhe keqtrajtimit fizik gjatë paraburgimit; kufizim i të drejtave të lirisë së shprehjes dhe të lëvizjes; eksproprijim arbitrar të pronës private;*

¹⁷ Për më shumë, shih në ueb faqen e Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës ku theksohet se raportet për vizitat në Turqi në vitin 2016 dhe 2017 nuk janë publikuar ende: <https://www.coe.int/en/web/cpt/turkey>, (5.4.2018)

¹⁸ Zyra e Komisionerit të Lartë të OKB për të Drejtat e Njeriut, Raporti për Turqinë, në: http://www.ohchr.org/Documents/Countries/TR/2018-03-19_Second_OHCHR_Turkey_Report.pdf, (5.4.2018)

dhe përdorim të metodave të ndëshkimit kolektiv të cilat kanë për synim anëtarët e familjeve të individëve të cilat janë të dyshuar për kryerje të veprave penale në situatë të gjendjes së jashtëzakonshme”.

114. **Prandaj, Avokati i Popullit vlerëson se autoritet e Republikës së Kosovës duke i dëbuar ata i ekspozuan në rrezik real për t’iu nënshtruar torturës, keqtrajtimit fizi dhe rrezikut real për shkelje serioze të të drejtave tjera të garantuara me instrumentet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.**
115. Si rezultat, në rastin e tanishëm Avokati i Popullit konstaton se autoritetet kompetente në rastin e tanishëm kanë shkelur:
- Nenin 29 paragrafi 2, 3 dhe 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës [E drejta e lirisë dhe sigurisë], Nenin 31 [E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm], Nenin 32 [E drejta për mjete juridike]
 - Nenin 14, paragrafi 1, Nenin 15, Neni 16 paragrafi 1 dhe 2, Nenin 17, paragrafi 2 dhe 6 Ligjit nr. 04/L-213 për Bashkëpunim Ndërkombëtarë Juridik në Çështje Penale.
 - Nenin 8 dhe 10 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut.
 - Nenin 9, paragrafi 1 dhe 2, Nenin 13 të Paktit Ndërkombëtarë për të Drejtat Civile dhe Politike.
 - Nenin 5, 6 dhe 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut
 - Nenin 1 paragrafi 1 të Protokollit nr. 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut.
 - Nenin 3 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 të Konventës kundër Torturës dhe Trajtimeve a Dënimeve të Tjera Mizore Çnjerëzore ose Poshtëruese.

Në bazë të këtyre konstatimeve, dhe në përputhje me nenin 135, par. 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 18 paragrafit 1, nën-paragrafit 7 të Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit rekomandon:

Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ministrisë së Drejtësisë

- *Me rastin e vlerësimit të statusit të të huajve në vendin tonë, të zbatohen me kujdes të gjitha garantitë dhe procedurat e garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Konventat ndërkombëtare, qoftë për dhënien e lejes së qëndrimit, largimit apo ekstradimit.*

Ministria e Punëve të Brendshme

- *Të njoftojë shprehimisht personeli e saj lidhur me kompetencat kushtetuese dhe ligjore të Avokatit të Popullit sa i përket qasjes pa paralajmërim, në çdo vend dhe çdo kohë në vendet ku mbahen apo mund të mbahen personat e privuar nga liria.*
- *Qeveria e Republikës së Kosovës të akordojë kompensim të përshtatshëm jo-material si shprehje e vullnetit të mirë dhe njohje për shkeljet e të drejtave të njeriut në frymën e nenit 41 të KEDNJ.*

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ("Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj") dhe nenin 28 të Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit ("Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, . . . duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë"), mirësisht Ju lutemi të na informoni për veprimet që do të ndërmerrni lidhur me këtë çështje.

Me nderime,

Hilmi Jashari

Avokat i Popullit

